

PËR RATIFIKINIIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË TURQISE PËR BASHKËPUNIMIN DHE NDIHMËN E NDËRSJELLË NË FUSHËN E DOGANAVE"

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për dispozitat kryesore kushtetuese", me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI POPULLOR
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Turqisë për bashkëpunimin dhe ndihmën e ndërsjellë në fushën e doganave".

Neni 2

Për zbatimin e kësaj Marreveshjeje ngarkohet Ministria e Financave.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë e pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.2140, datë 17.6.1998 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Rexhep Meidani

M A R R E V E S H J E
N D E R M J E T Q E V E R I S E S E R E P U B L I K E S S E S H Q I P E R I S E D H E
Q E V E R I S E S E R E P U B L I K E S S E T U R Q I S E P E R B A S H K E P U N I M I N D H E
A S I S T E N C E N E N D E R S J E L L T E N E C E S H T J E T D O G A N O R E

Qeveria e Republikes se Shqiperise dhe Qeverise se Republikes se Turqise qe ketej e tutje referohen si "Pale kontraktuese".

Duke marre ne konsiderate qe shkeljet e legjislacionit Doganor jane te demshme per ekonomine , tregtine , financat interesat kulturore dhe sociale te Shteteve te tyre respektive;

Duke marre ne konsiderate rendesine e sigurimit te vlersimit te sakte dhe mbledhjes se detyrimeve Doganore, taksave dhe shpenzimeve te tjera dhe komisionevembi importimin dhe eksportimin e mallrave , gjithashtu zbatimin e dispozitave mbi ndalimet , kufizimet dhe kontrollot;

Duke marre ne konsiderate qe perpjekjet per te parandaluar shkeljet e legjislacionit Doganor dhe perpjekjeve per te siguruuar mbledhjen e sakte te taksave doganore te importeve dhe eksporteve , tatimet dhe cdo shpenzim tjeter mund te behen me efektive permes kooperimit ndermjet Administratave Doganave te Paleve Kontraktuese;

Duke marre parasysh tendencat ne rritjen dhe shkallezimin e trafikut te paligishem te drogave narkotike dhe lendeve psikotropike dhe duke marre ne konsiderate qe ajo perben nje trezik per shendetin publik dhe shoqerine;

Duke patur ne konsiderate gjithashtu konventen nderkombetare perkatese duke inkurajuar asistencen e ndersjellte bilaterale gjithashtu Rekomandimet e Keshillit te Kooperimit Doganor (Organizata Boterore e Doganave),

bien dakord , per sa vijon

P E R K U F I Z I M E

Neni 1

Per qellimin e kesaj Marreveshje:

a) " Administrata e Doganave " do te thote:

- per Republiken e Shqiperise - Drejtoria e Pergjithshme e Dogananve e Ministrise se Financave;
- per Republiken e Turqise - Nensekretariati i Krye Ministrise per Doganat.

b) "LegjACION Doganor" do te thote dispozitat e percaktuara me ligje dhe rregulloret duke marre parasysh importimin , eksportimin, tranzitin e mallrave ose te cdo procedure tjeter doganore dhe duke lidhur detyrimet doganore ,taksat ose cdo tatim tjeter te mbledhur nga Administrata Doganore , ose per masat e ndalimeve , kufizimeve ose kontrolli e vena ne zbatim nga Administrata Doganore;

c) "Shkelje Doganore" do te thote cdo shkelje ose shkllje ne tentative e legjislacionit Doganor;

d) "Dorga narkotike " do te thote cdo substance natyrale ose sintetike e emertuar ne Listen I dhe II te Konventes Unike mbi drogat narkotike ;

e) "Substanca psikotropike" do te thote cdo substance natyrale ose sintetike, emertuar ne Listen I,II,III dhe IV te Konventes se KB 1971 mbi substancat psikotropike ;

f) " Prekursor" do te thote substanca kimike te kontrolluara te perdonura ne prodhimin e drogave narkotike dhe substancave psikotropike, te emertuara ne Listat I dhe II te Konventes te KB 1988 kunder Trafikut te Paligishem ne Drogat Narkotike dhe Substancave Psikotropike ;

g) " Levrimi i kontrolluar" do te thote teknika e lejimit ngarkesave ilegale ose te dyshuara si ilegale te drogave narkotike , substancave psikotropike dhe prekuoreve, ose substancave zevendesuese te tyre , per te kaluar , permes ose brenda territorit te nje nga ose me shume vendeve, me dijeni dhe nen mbikqyrjen e autoriteteve kompetente te tyre, me qellim per identifikimin e personave te perfshire ne kryerjen e shkeljes.

F U S H A E M A R R E V E S H J E S

Neni 2

1. Palet Kontraktuese , permes Administrates Doganore, do te asistojne tek njeri-tjetri, ne akord me dispozitat e caktuara ne kete Marreveshje, me qellim zbatimin e legjislacionit Doganor, sikurse vijon:

a) do te ndermarrin masa me qellim lehtesimin dhe ndihmen per levizjen e pasajereve dhe rrjedhjes se mallrave;

b) do te kooperojne dhe asistojne njeri-tjetrin ne parandalimin dhe hetimin e shkeljeve te legjislacionit doganor;

c) mbi bazen e nje kerkesa do t'i japid njera-tjetres informacion per tu perdonur me lidhe me zbatimin e legjislacionit doganor.

d) do te orvaten te kooperojne ne drejtim te kerkimeve, zhvillimin dhe aplikimin e procedurave te reja doganore, ne trajnimin dhe kembimin e personelit si dhe ne ceshtje te tjera me interes te ndersjellte.

2. Asistenca e ndersjellte sipas kesaj Marreveshje do te jebet ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne territorin e Shteteve te Paleve Kontraktuese dhe brenda komptencave dhe burimeve te Administratave Doganore.

FORMAT E KOOPERIMIT DHE ASISTENCA E NDERSJELLTE

Neni 3

Administratrat Doganore do ti japid njera-tjetres , me iniciative ose me kerkese, te gjithe informacionin e nevojshem ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshje. Ne vecanti , Administratrat doganore do te :

- a) shkembejne eksperiençen lidhur me parimet e kontrollit doganor, gjithashtu informacionin mbi mjetet e moderne dhe menyrat per parandalimin dhe hetimin e shkeljeve doganore;
- b) informojne njera tjetren mbi ndryshimet e konsiderueshme te bera ne legjislacionin e tyre doganor, mbi pajisjet e kontrollit doganor te perparuar dhe metodat e aplikimit te tyre se dhe mbi ceshtjet doganore me interes te ndersjellte.

KONTROLI I PERSONAVE, MALLRAVE DHE MJETEVE TE TRANSPORTIT

Neni 4

Administratrat Doganore, me iniciativen e tyre ose me kerkese, do te drejtojne kontrollin mbi;

- a) personat , e njojur ose te dyshuar si kryeres te shkeljeve te legjislacionit;
- b) mallrat, e njojur ose te dyshuar - nga Administratrat Doganore te Paleve Kontraktuese - si objekt i shkeljeve Doganore;
- c) cdo mjet transportit i njojur, ose i dyshuar, te jete perdorur per kryerjen e shkeljeve doganore.

VEPRIMTARIA KUNDER TRAFIKUT TE JASHTELIGJSHEM TE MALLRAVE TE FORTE

Neni 5

Administratrat Doganore, me iniciativen e tyre ose me kerkese, do ti japid njera tjetres te gjithe informacionin perkates, qe ka lidhje me cdo veprimtari te organizuar, te kryer ose te qellimshme, e cila perben ose mund te perbeje nje shkelje te legjislacionit doganor te nje Pale Kontraktuese, mbi:

- a) trafikun e armeve, raketave, materialeve eksplozive dhe nukleare;
- b) trafikun e veprave te artit si vlera rendesishme arkeologjike , kulturore ose historike;

c) trafikun e drogave narkotike , substancave psikotropike , prekursoreve dhe substancave helmuese, gjithashtu te substancave te ttrezikshme per mjedisin dhe shendetin publik;

d) trafikun e mallrave qe i nenshtrohen perqindjeve te larta te detyrimeve doganore ose taksave.

DOREZIMI I KONTROLUAR

Neni 6

1. Ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te Paleve Kontraktuese, Administratat Doganore, brenda kompetencave te tyre, do te kooperojne per venien ne zbatim te metodave te dorezimit te kontrolluar.

2. Vendimi per te aplikuar proceduren e dorezimit te kontrolluar do te merret rast pas rasti, dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te Paleve Kontraktuese, duke perfshire financimin e nevojsphem dhe marreveshje te tjera.

3. Ngarkesat e ilegale, per te cilat bie dakord per dorezim te kontrolluar, me miratim te ndersjellte te autoritetit kompetent, mundet te ndalohen dhe te lejohen per drogat narkotike dhe substancat psikotropike, te mos cenohen ose dhe te hijet kjo procedure apo te zevendesohet teresisht ose pjeserisht

SHKEMBIMI I INFORMACIONIT

Neni 7

1. Administratat Doganore, me iniciativen e tyre ose me kerkese, do ti japid njera tjetres cdo informacion qe mund te ndihmoje ne zbatimin e procedurave me teper eficiente per :

a) percaktimin e vleres doganore dhe autenticitetin e dokumentacionit te paraqitur per import ose eksport, si dhe autenticitetin e te dhenave te permbajtura aty ;

b) klasifikimin e mallrave, sipas Tarifat Doganore, si dhe berjen e analizave laboratorike, per qellime te klasifikimit tarifor te mallrave perkundrejt tituje;

c) percaktimi i origjines se mallrave dhe kontrolli mbi certifikaten e origjines te paraqitura per eksport, dhe kontrollin mbi procedurat Doganore qe i akordohen mallrave nga vendi eksportues (tranzit nen kontrollin doganor, magazinave doganore, lejimet e perkohshme, zonat e tregut te lire, eksporti pas perpunimit aktiv , etj.).

2. Administrata Doganore e njeres nga Palet Kontraktuese, me iniciative ose me kerkese, do te jape Administrates Doganore te Pales tjeter Kontraktuese dokumentat doganore, dokumentat e transportit , registrat e fakteve dhe kopjot e vertetuara te tyre, dhe informacion mbi veprimtarite e kryera ose te qellimshme, qe perbejne ose mund te perbejne nje shkelje te legjislacionit doganor ne fuqi ne territorin e Shtetit tjeter.

Neni 8

Administratrat Doganore, me iniciativen e tyre ose me kerkese, do t'i japid njera tjetres informacionin qe vijon:

a) ne se mallrat, e importuara brenda territorit te Shtetit te nje nga Palet Kontraktuese, kane qene ligjerisht te eksportuara nga territori i Shtetit te Pales tjeter Kontraktuese;

b) nese mallrat e eksportuar nga territori i Shtetit te njerëz nga Palet Kontraktuese kane qene ligjerisht te importuara brenda territorit te Shtetit te Pales tjeter Kontraktuese.

Neni 9

Aministratrat Doganore, me iniciativen e tyre ose me kerkese, do ti japid njera tjetres cdo informacion qe lidhet me shkeljet e legjislacionit doganor ne fuqi ne territoret e te dy Shteteve dhe, ne vecanti, informacion mbi:

a) personat fizike dhe juridike, te njojur ose te dyshuar per kryerjen e shkeljeve te legjislacionit doganor ne fuqi ne territoret e te dy Shteteve;

b) mallrat e njojur ose te dyshuar te jene objekte te shkeljeve doganore;

c) mjetet e transportit , te njojur ose te dyshuar si te perdorur per kryerjen e shkeljeve te legjislacionit doganor ne fuqi ne territoret e te dy Shteteve.

Neni 10

Nqs Administrata Doganore e Pales Kerkuese nuk e ka informacionin e kerkuar , ajo do te shpejtoje qe ta perftoje nje informacion te tille sikur te vepronente ne emer te saj dhe ne perputhje me legjislacionin ne fuqi ne territorin e Shtetit te saj.

Neni 11

Informacioni i dhene Pales tjeter Kontraktuese mund ti transmetohet asaj nepermjet cdo mjeti elektronik ne kembim te dokumentave te specifikuar ne kete Marreveshje. Ai duhet te permboje shpjegimet e nevojshme per interpretimin dhe perdorimin e ketij informacioni.

FORMAT DHE PERMBAJTJA E KERKESAVE PER ASISTENCE

Neni 12

1. Kerkesat ne zbatim te kesaj Merreveshje do te behen me shkrim. Kerkesat do te permbojne shpjegime te nevojshme per realizimin e tyre. Ne raste te vecanta, kerkesat mund te behen gojarisht por do te konfirmohen shpejt me shkrim.

2. Kerkesat, sipas Paragrafit (1) te ketij Neni do te permbojne:

a) emrin e Administrates Doganore qe ben kerkesen ;

- c) objektivat dhe shkaqet per kete kerkese;
- d) ligjet dhe aktet e tjera ligjore, duke ju referuar objektit te kerkeses;
- e) te dhena me precise dhe te detajuara mbi personat fizike dhe juridike, te perfshire ne hetime;
- f) nje permblehdje te fakteve, qe kane lidhje me objektin e kerkeses.

3. Kerkesat do te paraqiten ne gjuhen zyrtare te Pales Kerkuese, ne Anglisht ose ne Frengjisht.

4. Nqs nje kerkese nuk do te plotesoje kushtet e Paragrafeve (2) dhe (3) te ketij Neni, mund te kerkohet te plotesohet.

H E T I M E T D O G A N O R E

Neni 13

1. Nqs Administrata Doganore e njeres prej Paleve Kontraktuese e kerkon, Administrata Doganore e Pales tjeter Kontraktuese do te filloje hetimet ne territorin e Shtetit te saj per operacionet qe shkelin ose mund te shkelin legjislacionin doganor ne fuqi ne territorin e shtetit te Pales Kerkuese. Ajo do ti sjelle rezultatet e nje hetimi te tille ne vemandje te Pales Kerkuese.

2. Keto hetime do te drejtohen sipas legjislacionit ne fuqi ne territorin e Shtetit te Pales Kerkuese. Administrata Doganore Kerkuese do te procedoje sikur te vepronte per llogari te saj.

3. Nenpunesit e Administrates Doganore te njeres prej Paleve Kontraktuese, ne raste te vecanta, me miratim te Administrates Doganore te Pales tjeter Kontraktuese, mund te paraqiten ne territorin e kesaj te fundit per shqytimin e shkeljeve te legjislacionit Doganor te Shtetit perkates. Ata duhet te provojne kapacitetin e tyre zyrtar.

4. Nje zyrtar i Administrates Doganore te Pales Kerkuese i paraqitur ne territorin e Pales se Kerkuar ne kuadrin e Paragrafit (3) vepron vetem ne kapacitetin e keshilltarit dhe cilado qofshin trethanat asnjehere nuk do te marre pjese aktive ne hetim dhe asnjehere nuk do te takohet me personat qe merren ne pyejte dhe as te asistoje aktivisht ne hetim.

P E R D O R I M I I I N F O R M A C I O N I T D H E D O K U M E N T A V E

Neni 14

1. Informacioni, dokumentat dhe te dhenat e marra ne kuadrin e kesaj Marreveshje nuk perdoren per qellime te tjera nga cfare percaktohet ne kete Marreveshje. Per qellime te tjera ato mund te perdoren vetem me pelqimin me shkrim te Administrates Doganore qe i ka dhene ato.

2. Informacioni dhe dokumentat qe lidhen me trafikun e jashtligjshem te drogave narkotike , substancave psikotropike dhe prekursoreve mundet t'i jepen edhe

aoturiteteve te tjera shteterore te Pales Kontraktuese aktivitetet e te cilave perfshijne kontrollin e shkeljeve me drogat dhe trafikun e jashteligjshem te narkotikeve , substancave psikotropike dhe prekursoreve.

3. Cdo kerkese e bere dhe informacion i dhene ne vijim te kesaj Marreveshje, i cfaredo forme qofte, eshte i natyres konfidenciale. Ai duhet te ruhet si konfidencial dhe do te gezoje mbrojtjen qe i takon te njejtit lloj informacioni dhe dokumentacioni sipas legjislacionit ne fuqi ne territorin e Shtetit te Pales Kerkuese.

Neni 15

1. Administrata Doganore qe merr informacion dhe dokumenta sipas kesaj Marreveshje mundet , ne vartesi te qellimit dhe fushes, t'i perdore ato si prova gjate procedimeve administrative dhe juridike dhe ne kerkesat per gjykim.

2. Nje informacion dhe dokumentacion i tille do te perdoret per te prodhuar prova ne gjykate dhe statusi ligjor i tyre do te percaktohet ne perputhje me legjislacionin kombtar te Shtetit te Administrates Doganore marrese.

E K S P E R T E T D H E D E S H M I T A R E T

Neni 16

1. Sipas kerkeses se nje Administratore Doganore te njeres prej Paleve Kontraktuese, Administrata Doganore e Pales tjeter Kontraktuese mund t'i autorizoje nenpunesit e saj , me pelyqimin e ketyre te fundit, te paraqiten si eksperte ose deshmitare perpara autoriteteve administrative apo ligjore te Pales Kerkuese. Keta nenpunes janin prova qe i kane perftuar gjate ushtrimit te detyrave te tyre.

2. Administrata Doganore e Pales Kerkuese eshte e detyruar te marre te gjithe masat e nevojshme per mbrojtjen e sigurise personale te nenpunesve gjate qendrimit te tyre ne territorin e shtetit te saj , konform Paragrafit (1) te ketij Neni . Transporti dhe shpenzimet ditore te ketyre nenpunesve do te mbulohen nga Administrata Doganore e Palese Kerkuese.

P E R J A S H T I M E N G A D E T Y R I M I P E R D H E N I E N E A S I S T E N C E S

Neni 17

1. N.q.se Administrata Doganore e kerkuar e konsideron se perm bushja e nje kerkese eshte e ne kundershtim me sovranitetin , sigurine ose ndonje interes tjeter thelbesor te atij shteti ajo mund te refuzoje dhenien sipas kushteve te kesaj Marreveshje, plotesisht ose pjeserisht, ose ta kufizoje dhenien e asistences se kerkuar me disa rrethane te caktuara.

2. N.q.se Administrata doganore Kerkuese kerkon asistence te cilen vet nuk do te ishte ne gjendje t'ja jepte Administrates Doganore te Shtetit tjeter , ky fakt duhet te permendet ne kerkesen per asistence. Perm bushja e nje kerkese te tille eshte ne kompetencen e Pales se Kerkuar.

N.q.se refuzohet asistenca, arsyet e refuzimit duhet t'i njoftohen Pales

ASISTENCA TEKNIKE

Neni 18

Administratat Doganore do t'i japid njera-tjetres asistence teknike per ceshtjet Doganore, si me poshte vijon;

- a) kembimi i nenpunesve doganor me qellim njohjen e tyre me mjetet e avancuara qe perdoren per kontroll doganor;
- b) kembim informacioni dhe ekspertize ne drejtim te perdonimit te pajisjeve teknike te kontrollit;
- c) trajnimin dhe ritrajnimin e personelit doganor;
- d) kembimin e eksperteve per problemet doganore
- e) kembimin e te dhenave teknike dhe shkencore , specifike, qe lidhen me aplikimin e dispozitave doganore.

S H P E N Z I M E T

Neni 19

- 1. Pala e Kerkuar do te mbuloje te gjitha shpenzimet qe lidhen me zbatimin e kerkesave te parashikuara ne kete Marreveshje.
- 2. Shpenzimet qe lidhen me zbatimin e Neneve 7 dhe 19 te kesaj Marreveshje do t'i nenshtrohen negociatave ndermjet Administratave Doganore.

Z B A T I M I I M A R R E V E S H J E S

Neni 20

- 1. Kooperimi dhe asistenca e ndersjellte , te pasqyruara ne kete Marreveshje, do te realizohen nga Administratat Doganore te Paleve Kontraktuese. Keto autoritete bien dakord reciprokisht mbi dokumentacionin per ate qellim.
- 2. Perfaqsuesit e Paleve Doganore te Paleve Kontraktuese do takohen sipas nevojes, te pakten nje here ne vit, me rradhe ne territorin e njerit Shtet ose tjeterit me qellim analizimin e venies ne zbatim te dispozitave te kasaj Marreveshje si dhe per te zgjidhur problemet e tjera praktike te kooperimit dhe asistences se ndersjellte per Administratat Doganore te Paleve Kontraktuese.
- 3. Administratat Doganore te Paleve Kontraktuese do te percaktojne se bashku metoden per venien ne zbatim ne praktike te kesaj Marreveshje.
- 4. Per qellime te kesaj Marreveshje, Administratat Doganore te Paleve Kontraktuese do te caktojne ne pune nenpunesit perjeqjes per komunikim dhe do te kembjne nje liste ku tregohen emrat , titujt numrat e telefonave dhe fakseve te ketvje

nenpunesve. Gjithashtu , Palet kontraktuese mundet te bien dakord qe deget hetimore te tyre te kontaktojne direkt me njera- tjetren.

5. Kryetaret e zyrave doganore kufitare te Paleve Kontraktuese, ose personel i tyre i autorizuar ne menyre te rregullt mundet te jene ne kontakt direkt per gjate ekzekutimit te detyrave te tyre.

V L E F S H M E R I A

Neni 21

1. Kjo Marreveshje do te qendroje ne fuqi per nje periudhe prej pese vjetesh dhe zgjatet automatikisht per nje periudhe tjeter prej nje viti.

2. Kjo Marreveshje perfundon brenda tre muajve nga data e marrjes se denoncimit me shkrim nga njera prej Paleve Kontrktuese .

H Y R J A N E F U Q I

Neni 22

Kjo Marreveshje do te hyje ne fuqi ne diten e 30 nga data e kembimit te Notave ndermjet Paleve Kontraktuese, me te cilat njoftohet ratifikimi i Marreveshjes ne peruthje me legjislacionin e tyre kombetar.

Firmosur ne , me 1998 , ne dy kopje ne gjuhet turqisht, shqip dhe anglisht, ku te gjitha kopjet jane autentike. Ne rast divergjence ndermjet teksteve shqip dhe turqisht do te mbizoteroje teksti ne anglisht.

**PER QEVERINE E REPUBLIKES SE
SHQIPERISE**

**PER QEVERINE E REPUBLIKES
SE TURQISE**